



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Kancelarija Ministra Pravde – Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 47/2024
Datë: 01/03/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Muamer Bikliqi, Zëvendësues i Kryeinspektorit të Ministrisë së Drejtësisë, caktohet ushtrues detyre i Kryeinspektorit në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij ti kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
1. Periudha e ushtrimit të detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi është gjashtë (6) muaj fillon nga data 01/03/2024.
2. Obligohet Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 281/2022, i datës 06/10/2022.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pozita e Kryeinspektorit në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë si pozitë e kategorisë së lartë drejtuese është pozitë e lirë, dhe z. Muamher Bikliqi me aktemërim të datës 03/05/2013 i plotëson kushtet për t'u caktuar si ushtrues detyre në përputhje me nenin 35

(2) të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke qenë se bënë pjesë në kategorinë e mesme drejtuese, që është kategori pasuese e kategorisë së lartë drejtuese. Duke pas parasysh faktin se pozita është vakante dhe me qëllim të mbarëvajtjes së punës në Kryeinspektorit në Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe duke vepruar në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Z. Muamer Bikliqi;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;*
- *Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, dhe*
- *Arkivit e Ministrisë së Drejtësisë.*